

ANEKS MARREVESHJE

Emertimi

FORUMI RAJONAL AFTESIA E KUFIZUAR DHE INTEGRIMI, SHKODER FRAKISH

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder deklaron se:

Duke qënë të ndërgjegjshëm se personat me aftësi të kufizuar ende përballen me mosrespektimit të të drejtave të njeriut dhe formave shumëfishe të diskriminimit prezente këto edhe në Rajonin e Shkodrës, janë në kushte të vështira jetësore, kanë pamundësi të aksesit në ambientet fizike, shoqërore, shëndetësore, ekonomike, kulturore, arsimore në informacion e komunikim:

bie dakord si më poshtë

PJESA E PARË

Themelimi

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder është rrjet bashkëpunimi, me pjesëmarrjen e disa prej: Agjensive të Zhvillimit, OJF- ve vendore në fushën e të drejtave të njeriut dhe aftësisë të kufizuar, media, Kompanive të Biznesit, Institucioneve lokale dhe rajonale dhe kërkuesve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit. Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder është rrjet i hapur që bashkon grupe të interesuara në çështjet e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit.

Emërtimi

Emërtimi i këtij rrjeti është Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder.

Misioni

Forumi Rajonal Aftesia e Kufizuar dhe Integrimi Shkoder ka mision promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet bashkëpunimit aktiv, shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës nderdisiplinore ndërmjet anëtarëve të Forumit për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit në Shqipëri dhe më specifikisht në Rajonin e Shkodrës.